



*ALBANIAN
FINANCIAL
INTELLIGENCE
UNIT*

Raporti Vjetor

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit
të Pastrimit të Parave

Viti 2016

RAPORTI

XII



ALBANIAN
FINANCIAL
INTELLIGENCE
UNIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PARANDALIMIT TË PASTRIMIT TË PARAVE

RAPORTI VJETOR 2016

Nr. XII

TIRANË, 2017

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
www.fint.gov.al
Ministria e Financave,
Bulevardi “Deshmoret e Kombit”,
nr 3, Tiranë.
Tel: +355 4 22 44 602

PËRMBAJTJA

| | |
|--|----|
| MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM | 5 |
| SHKURTIME | 6 |
| HYRJE | 8 |
| DATA KRYESORE | 9 |
| RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE | |
| DHE MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT | 11 |
| Raportime në kuadër të luftës kundër pastrimit të parave..... | 11 |
| Masat kundër financimit të terrorizmit..... | 11 |
| NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE, MASAT PARANDALUESE | |
| DHE PËRPUTHSHMËRIA | 12 |
| Ndërgjegjësimi i subjekteve raportuese..... | 12 |
| Analizimi i përputhshmërisë, inspektimet në vend dhe në distancë..... | 13 |
| Masat administrative | 15 |
| Të dhëna mbi arkëtimet për periudhën 2014 - 2016 | 16 |
| MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT | |
| FINANCIAR DHE MASAT E PËRKOHSHME | 17 |
| Raportet e aktivitetit të dyshimtë..... | 17 |
| Analizimi financiar dhe referimi në organet e zbatimit të ligjit..... | 19 |
| Masat e përkohshme/urdhrat e bllokimit..... | 21 |
| TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJZBATUESE | 22 |
| Rast 1 - Transaksione biznesi të kryera CASH në vlera të larta..... | 22 |
| Rast 2 - Përfshirja në transaksione të larta të personave të lidhur me PEP | 24 |
| Rast 3 - Blerje pasurie të paluajtshme në vlerë të lartë nëpërmjet ankandit | 25 |
| Rast 4- Qarkullim i dyshimtë i shumave të larta në sistemin bankar..... | 27 |
| Rast 5 - Qarkullim i shumave të larta në llogari nëpërmjet transfertave bankare..... | 27 |
| Rast 6 - Qarkullim i shpeshtë i shumave të larta në sistemin bankar..... | 29 |

| | |
|--|-----------|
| BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE..... | 31 |
| Burimet buxhetore dhe menaxhimi i tyre..... | 31 |
| Menaxhimi i burimeve njerëzore | 31 |
| Zhvillimet teknologjike | 33 |
| BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR | 34 |
| Bashkëpunimi ndërinstitucional..... | 34 |
| Bashkëpunimi ndërkombëtar..... | 35 |
| Bashkëpunimi në kuadrin e Grupit EGMONT | 35 |
| Bashkëpunimi me Komitetin MONEYVAL të KiE | 35 |
| Shkëmbimi i informacionit me NJIF-in..... | 36 |
| OBJEKTIVAT PËR VITIN 2017..... | 37 |

MESAZHI I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar lexues,

Kam kënaqësinë që me anë të këtij botimi të prezantoj veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave gjatë vitit 2016. Publikimi i raportit vjetor, përveçse një detyrim ligjor, është një moment i rëndësishëm, kur DPPPP-ja ndan me publikun treguesit kryesor të performancës në lidhje me veprimtarinë e saj.

Vendi ynë ka shënuar progres në masat e mara për garantimin e një sistemi funksional parandalues dhe goditës ndaj krimit ekonomik, specifikisht ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Jemi të vetëdijshëm se kemi akoma shumë për të bërë në këtë drejtim dhe çdo arritje na shton motivimin dhe vendosmërinë për ta kthyer në një histori suksesi luftën ndaj këtyre fenomeneve.

Miratimi i reformës në drejtësi ishte një moment kulmor dhe historik për vendin tonë. Roli që i është besuar DPPPP-së, në kuadër të kësaj reforme, është vlerësim dhe shenjë besimi ndaj këtij institucioni, që vlen të evidentohet. Në

vijimësi, kemi marrë përkrahjen e gjithanshme të qeverisë, Ministrisë së Financave dhe organeve të Kuvendit të Shqipërisë për punën e kryer dhe sfidat e vazhdueshme që na presin.

Gjatë vitit 2017 në fokusin tonë do të jetë kryesisht konsolidimi i procesit të përputhshmërisë mbi bazën e riskut, bashkërendimi i punës me autoritetet mbikëqyrëse dhe përmbushja e detyrimeve, që rrjedhin nga procesi i vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës.

Në përfundim, do të doja të përgëzoja stafin e DPPPP-së për punën e palodhshme dhe nivelin e lartë të profesionalizmit. Raporti që do të paraqesim, përveç të tjerash, është edhe tregues i vizionit dhe përkushtimit të dy drejtuesve të DPPPP-së gjatë vitit 2016, z. Genti Gazheli dhe z. Alket Hyseni, të cilët gjej rastin t'i falënderoj për kontributin në arritjet e paraqitura në këtë raport.

Në vijim, ju uroj lexim të këndshëm!

“

Jemi të vetëdijshëm se kemi akoma shumë për të bërë në këtë drejtim dhe çdo arritje na shton motivimin dhe vendosmërinë për ta kthyer në një histori suksesi luftën ndaj këtyre fenomeneve. ”


ARLIND GJOKUTA

SHKURTIME

AMF - Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

BSH - Banka e Shqipërisë

BE - Bashkimi Evropian.

DPD - Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

DPPPP - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

DPPSH - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

DPT - Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

EGMONT - Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë.

EKA - Ekspert Kontabël i Autorizuar.

FATF - Grupi i Veprimit Financiar.

KBLKPP - Komiteti i Bashkëndimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

KiE - Këshilli i Evropës.

MONEYVAL - Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave.

NjIF - Njësi e Inteligjencës Financiare.

PEP - Personat e Ekspozuar Politikisht.

PPP/FT - Parandalimi i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

RAD - Raporti i Aktivitetit të Dyshimtë.

RTPF - Raporti i Transaksioneve në Para Fizike.

ZKV - Zyrë Këmbimi Valutor.

ZQRPP - Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

HYRJE

Viti 2016, me dinamikën e vet pozitive, ka konsoliduar akoma më tej zhvillimin e qëndrueshëm të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave si dhe ka forcuar pozitën e saj, si aktor kyç në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Reforma në sistemin e drejtësisë dhe "vetingu", si një komponent kyç i kësaj reforme, ka kaluar në tjetër nivel rolin e DPPPP-së, duke i dhënë vlerë përpjekjeve shumëvjeçare për rritjen e besimit në këtë institucion dhe promovimin e aftësive profesionale të stafit.

Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar ka sjellë rritje të cilësisë dhe shpejtësisë së shkëmbimit të informacionit financiar.

Ruajtja e integritetit të sistemit financiar dhe mbikëqyrja e duhur e masave parandaluese për të gjithë subjektet e ligjit ka pasur vëmendjen parësore të DPPPP-së, shprehur kjo përmes takimeve të punës, trajnimeve, inspektimeve në vend dhe në distancë, bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, shpërndarjen e tipologjive etj.

DATAT KRYESORE

- Në maj të vitit 2000 Parlamenti Shqiptar, pas kërkesave të ripërsëritura të Këshillit të Evropës dhe të Komitetit MONEYVAL, miratoi ligjin nr. 8610, datë 17.05.2000 "*Për parandalimin e pastrimit të parave*";
- Në gusht të vitit 2001 u krijua për herë të parë, në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave;
- Në qershor të vitit 2003, Parlamenti Shqiptar, në zbatim të kërkesave të raportit të vlerësimit të dytë të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL, miratoi disa ndryshime të rëndësishme të ligjit "*Për Parandalimin e Pastrimit të Parave*", nëpërmjet miratimit të Ligjit nr. 9084 datë 19.06.2003 "*Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 8610, datë 17.05.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave"*";
- Në korrik të vitit 2003, Njësia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë u bë anëtare me të drejta të plota në Grupin EGMONT gjatë sesionit plenar të mbajtur në Australi;
- Në gusht të vitit 2005, Drejtoria e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave u ngrit në nivelin e Drejtorisë së Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave, në Ministrinë e Financave;
- Në gusht të vitit 2006, KBLKPP-ja miratoi Programin Kombëtar të Kontrollit të Lëvizjes së Parasë në dorë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- Në nëntor të vitit 2006 u miratua Ligji nr. 9641, datë 20.11.2006, "*Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për parandalimin e terrorizmit"*" dhe Ligji nr. 9646, datë 27.11.2006 "*Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës "Për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe të financimit të terrorizmit"*";
- Në maj të vitit 2008, Parlamenti Shqiptar miratoi Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008, "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit"*", i cili hyri në fuqi në shtator të po atij viti;
- Në tetor të vitit 2009, me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1077, datë 27.10.2009 u miratua Dokumenti Strategjik Kombëtar "*Për hetimin e krimit financiar*", në hartimin e të cilit DPPPP-ja kishte rol drejtues;
- Në nëntor të vitit 2010 u zhvillua në vend vizita e Misionit të Katërt Vlerësues të Fondit Monetar Ndërkombëtar për masat e marra nga Shqipëria në parandalimin e goditjes së pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Në mars të vitit 2011, Parlamenti Shqiptar, nëpërmjet Ligjit nr. 10391 datë 03.03.2011, miratoi disa ndryshime të ligjit "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit"*";
- Në prill të vitit 2011, Komiteti MONEYVAL i KiE-së miratoi raportin e raundit të katërt

- për Shqipërinë, ku pasqyrohej vlerësimi në rritje për Rekomandimin e 26-të FATF-së, që lidhej drejtpërdrejt me veprimtarinë e DPPP-së si Njësi e Inteligjencës Financiare;
- Në qershor të vitit 2012, Parlamenti Shqiptar miratoi disa ndryshime të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "*Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit*";
 - Në tetor të vitit 2012 përfundoi dhe iu paraqit KBLKPP-së dokumenti për vlerësimin kombëtar të riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
 - Në muajin tetor të vitit 2013, DPPP-ja, për herë të parë, organizoi Konferencën Rajonale të Drejtuesve të NjIF-së;
 - Në muajin tetor të vitit 2013, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin "*Për masat kundër financimit të terrorizmit*";
 - Në maj të vitit 2015, Shqipëria përmbylli procesin e realizimit të rekomandimeve të FATF-së dhe u hoq nga lista publike e vendeve me mangësi në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
 - Në qershor të vitit 2015 përfundoi rishikimi i vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT-në. Dokumenti u shpërnda në institucionet dhe autoritetet përkatëse;
 - Në shtator të vitit 2015, Komiteti MONEYVAL i KiE-së mori në shqyrtim progresin e bërë nga vendi ynë në drejtim të rekomandimeve të raundit të katërt të vlerësimit dhe bazuar në masat e ndërmarra nga autoritetet vendosi ndërprerjen e procedurës së mbikëqyrjes së përforcuar;
 - Në nëntor të vitit 2016 u miratua me Vendim të Këshillit të Ministrave, me procedurë të brendshme, shpallja e listës së personave të dyshuar si terroristë.

RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

RAPORTIME NË KUADËR TË LUFTËS KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave është përfshirë në mënyrë aktive në grupet e punës, në kuadër të proceseve për integrimin e vendit në BE, duke dhënë kontribut për sa i takon aktivitetit të saj.

Në këtë kuadër, DPPP-jë është anëtare e Grupit Ndërinstitucional të Punës për kapitullin 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", kapitullin 31 të PKIE-së "Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes" dhe kapitullin 4 "Lëvizja e lirë e kapitalit".

DPPP-jë është edhe pjesë e grupit të punës për adresimin e pesë prioriteteve të BE-së dhe ka qenë veçanërisht e përfshirë në masat kyçe, **që lidhen me** prioritetin 4 "Lufta kundër krimit të organizuar".

Vlen të theksohet se, **të gjitha masat e parashikuara në planet e punës dhe objektivat e vendosura në kuadër të këtyre angazhimeve janë përmbushur nga DPPP-jë** brenda afateve të parashikuara.

MASAT KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Financimi i terrorizmit dhe aktet terroriste paraqesin një sfidë për mbarë botën dhe

vendosin NjIF dhe organet zbatuese të ligjit përballë nevojës së marrjes së masave të duhura për një reagim të shpejtë dhe efikas.

DPPP, në zbatim të Ligjit nr. 157/2013, datë 10.10.2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", i ka kushtuar rëndësi të veçantë masave të marra nga subjektet raportuese të ligjit për PPP/FT-në, por edhe nga institucionet dhe aktorët e tjerë të përfshirë në luftën kundër financimit të terrorizmit.

Janë ndjekur në vijimësi ndryshimet që ka pësuar lista e personave të shpallur si financues të terrorizmit, sipas vendimeve të Komitetit të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara si dhe ndryshimeve në VKM-në nr. 718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit".

Në zbatim të Rezolutës 1373 (2001) së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Nenit 15 të Ligjit nr. 157/2013 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me Vendim nr. 769, datë 02.11.2016 të Këshillit të Ministrave është realizuar shpallja e personave si terroristë, me procedurë të brendshme e me propozim të institucioneve vendase.

NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE. MASAT PARANDALUESE DHE PËRPUTHSHMËRIA

NDËRGJEGJËSIMI I SUBJEKTEVE RAPORTUESE

Si pjesë integrale e përmbushjes së detyrave që ngarkon ligji, DPPPP-ja është treguar tepër aktive në ndërgjegjësimin, sensibilizimin dhe trajnimin e subjekteve të ligjit, duke organizuar takime me subjektet e ligjit dhe me autoritetet mbikëqyrëse.

Në fokus të DPPPP-së, ka qenë ndarja e praktikave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit me subjektet financiare bankare e jo-bankare dhe profesionet e lira jo-financiare, për të mundësuar sensibilizimin e tyre për rëndësinë që ato kanë në sistemin parandalues.

Tabela 1. Numri i personave të trajnuar sipas subjekteve në periudhën 2014 – 2016

| Subjekti | Numri i personave të trajnuar | | |
|---|-------------------------------|------------|------------|
| | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 |
| Banka të nivelit të dytë | 120 | 285 | 108 |
| ZKV | 70 | 73 | 77 |
| Institucione jo bankë | 68 | 115 | 188 |
| Lojëra fati | 12 | 0 | 6 |
| Noterë | 237 | 73 | 127 |
| EKA | 1 | 0 | 1 |
| Shoqëri sigurimi | 0 | 35 | 1 |
| Autoritete mbikëqyrëse dhe institucione (AMF, ZQRPP, DPPSH, DPD, DPT) | 139 | 58 | 108 |
| Shoqëri tregtimi të automjeteve | 14 | 0 | 3 |
| Organizata jofitimprurëse | 0 | 45 | 0 |
| Shoqëri ndërtimi | 38 | 0 | 8 |
| Institute të pensioneve private | 0 | 5 | 1 |
| TOTALI | 699 | 689 | 628 |

Të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme dëshmojnë më së miri se institucioni ynë ka mundur ndër vite një qasje të një numri të madh personash në trajnimet e organizuara, por edhe një gamë të gjerë të kategorive të subjekteve të përfshira.

Përveç pjesëmarrjes në aktivitete të ndryshme trajnimi/sensibilizimi, subjektet e ligjit, gjatë procesit të inspektimit, janë trajnuar në mënyrë të posaçme, duke lënë rekomandime për përmirësim dhe masat që duhet të ndërmerren në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Në mënyrë të veçantë, nga mangësitë e vërejtura prej monitorimit në distancë janë udhëzuar në rrugë elektronike subjektet e ligjit për saktësinë e raportimeve.

Gjithashtu, vëmendje e shtuar i është kushtuar reagimit për RAD, si një formë e udhëzimit dhe ndërgjegjësimit të subjekteve për saktësi e korrektesë në informacionin që dërgojnë.

ANALIZIMI I PËRPUTHSHMËRISE, INSPEKTIMET NË VEND DHE NË DISTANCË

Monitorimi dhe vlerësimi i nivelit të përputhshmërisë së subjekteve raportuese me detyrimet e legjislacionit për parandalimin e

pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit përbën një ndër detyrat funksionale të DPPP-së.

Realizimi i kësaj detyre është siguruar nëpërmjet kombinimit të inspektimeve në vend dhe në distancë, shqyrtimit të raportimeve të bëra nga subjektet e ligjit dhe bashkëpunimit me autoritetet mbikëqyrëse.

Bazuar në përvojën e krijuar në vitet e mëparshme, gjatë këtij viti, puna e DPPP-së është orientuar në treguesit e analizës së riskut të përputhshmërisë, duke u përqendruar në kategoritë e subjekteve, të cilat renditen me risk të mesëm apo të lartë për sa i përket shkallës së ekspozimit ndaj pastrimit të produkteve të veprës penale, duke synuar forcimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të sistemit parandalues.

Mbikëqyrja në distancë është realizuar nëpërmjet raporteve të vetëkontrollit, që iu dërgohen periodikisht subjekteve. Me anë të këtyre raporteve sigurohen të dhëna mbi nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga ana e subjekteve, saktësi dhe cilësi të raportimit si dhe trajnimet e kryera.

Një nga çështjet më parësore të punës së DPPP-së gjatë këtij viti, ka vijuar të jetë koordinimi me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese, dhe në këtë kontekst janë realizuar një sërë inspektimesh të përbashkëta në subjektet financiare. Për këtë qëllim është bashkëpunuar me BSH dhe A.M.F

Tabela 2. Inspektimet në vend dhe në distancë për periudhën 2014-2016

| Nr. | Subjektet e inspektuara | Viti 2014 | | Viti 2015 | | Viti 2016 | |
|---------------|-------------------------------------|------------|-------------|------------|-------------|------------|-------------|
| | | Në vend | Në distancë | Në vend | Në distancë | Në vend | Në distancë |
| 1 | Banka | 7 | - | 6 | 7 | 9 | - |
| 2 | Institucione financiare jo bankë | 3 | 1 | 7 | 2 | 9 | - |
| 3 | ZKV | 19 | 8 | 22 | 6 | 12 | 1 |
| 4 | Shoqëri ndërtimi | 18 | - | 15 | 7 | 8 | 14 |
| 5 | Noterë | 4 | 67 | 13 | 1 | 21 | 28 |
| 6 | Lojëra fati | 3 | - | - | 8 | 6 | - |
| 7 | Metale të çmuara | 3 | - | - | - | - | - |
| 8 | EKA | 3 | 16 | 5 | 1 | 1 | 1 |
| 9 | Agjenci pasurish të paluajtshme | 2 | - | - | - | 4 | - |
| 10 | Mjete motorike | 8 | 1 | - | - | 3 | 1 |
| 11 | Sigurimi i jetës | 1 | - | 2 | - | 1 | - |
| 12 | Agjenci udhëtimi | 1 | - | - | - | - | - |
| 13 | Studio ligjore | - | - | 3 | - | - | - |
| 14 | Shoqëri transporti | - | - | 1 | - | - | - |
| 15 | Vepra arti | - | - | 1 | - | - | - |
| 16 | Shoqëri administrimi letra me vlerë | - | - | - | 4 | - | - |
| 17 | Shoqëri kursim krediti | - | - | - | 4 | 2 | - |
| 18 | Fonde pensioni | - | - | - | - | 1 | - |
| Shuma | | 72 | 93 | 75 | 40 | 77 | 45 |
| TOTALI | | 165 | | 115 | | 122 | |

Disa nga mangësitë kryesore, të evidentuara gjatë procesit të analizës së përputhshmërisë së subjekteve të ligjit për vitin 2016 janë:

- Mosraportimi i transaksioneve të kryera në para fizike mbi pragun e përcaktuar në ligj;
- Mosidentifikimi i klientëve dhe mosruajtja e dokumenteve në përputhje me parashikimet ligjore;
- Moskryerja e analizave për transaksionet komplekse në vlera të larta, të pazakonta dhe të pajustificuara nga pikëpamja ekonomike;

- Mosushtrimi i masave të "vigjilencës së zgjeruar" për kategoritë e klientëve të konsideruar me risk të lartë;
- Mosngritja e një sistemi të centralizuar përgjegjës për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave duke përfshirë të dhënat minimale të parashikuara.

Për këto mangësi, DPPPP-ja ka vijuar procesin e shqyrtimit të kundërvajtjes administrative, ka lënë rekomandime për përmirësimin e situatës në subjekt dhe njëkohësisht ka vënë në dijeni autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese.

MASAT ADMINISTRATIVE

Ashtu siç u përmend edhe më lart, gjatë vitit 2016, një sërë subjektësh janë gjendur në mospërmbushjen e nivelit të përputhshmërisë me kuadrin rregullator për PPP/FT, për të cilat ka vijuar procesi i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative deri në dhënien e dënimit me gjobë sipas dispozitave përkatëse.

Përveç inspektimeve në vend, janë vlerësuar edhe praktikave të raporteve të vetëkontrollit apo indice të tjera nga monitorimi në distancë i subjekteve për shkelje të detyrimeve të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar.

Nga shqyrtimi i praktikave të inspektimit në vend dhe mbikëqyrja në distancë janë

konstatuar kundërvajtje administrative dhe janë vendosur 33 masa administrative (gjoba).

Kundërvajtjet administrative për subjektet e ligjit konsistojnë në shkelje të:

- Detyrimit për identifikimin e klientëve dhe ruajtjen e dokumenteve të identifikimit;
- Detyrimit për monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit dhe mbledhjen e të dhënave për burimin e fondeve;
- Detyrimit për ngritjen dhe funksionimin e njësisë të centralizuar për grumbullimin dhe analizimin e transaksioneve;
- Detyrimit për raportimin e transaksioneve në para fizike.

Tabela 3. Numri dhe vlera e gjobave në lekë sipas llojit të subjekteve të proceduara (2014-2016)

| Subjekte | Viti 2014 | | Viti 2015 | | Viti 2016 | |
|----------------------------|--------------|-------------------|--------------|-------------------|--------------|-------------------|
| | Nr. i masave | Vlera e gjobave | Nr. i masave | Vlera e gjobave | Nr. i masave | Vlera e gjobave |
| Banka të nivelit të dytë | 5 | 4'430'000 | 2 | 6'000'000 | 5 | 10'700'000 |
| Zyra këmbimi valutor | 7 | 4'300'000 | 8 | 6'800'000 | 5 | 3'500'000 |
| Noterë | 29 | 9'700'000 | 4 | 2'700'000 | 11 | 3'400'000 |
| Institucione jo bankë | 2 | 800'000 | 3 | 2'200'000 | 2 | 1'000'000 |
| Lojëra fati | 3 | 2'500'000 | - | - | 4 | 3'600'000 |
| Shoqëri ndërtimi | 11 | 6'800'000 | 15 | 14'700'000 | 4 | 3'800'000 |
| Agjenci udhëtimi | - | - | 1 | 300'000 | - | - |
| Shoqëri sigurimi jete | - | - | 1 | 2'000'000 | - | - |
| Tregtim i mjeteve motorike | - | - | - | - | 2 | 4'000'000 |
| TOTALI | 57 | 28'530'000 | 34 | 34'700'000 | 33 | 30'000'000 |

Minimumi i gjobës së aplikuar ka qenë 100'000 lekë dhe maksimumi 3'000'000 lekë. Vlera to-

tale e gjobave të vendosura gjatë këtij viti është 30'000'000 lekë.

TË DHËNA MBI ARKËTIMET PËR PERIUDHËN 2014 - 2016

Gjatë vitit 2016 janë arkëtuar 31'786'000 lekë në total, nga të cilat:

- 17'660'000 lekë janë arkëtime nga masat administrative të vendosura në vitin 2016 dhe
- 14'126'000 lekë janë arkëtime të masave administrative të mbartura nga vitet e mëparshme.

mënyrë, edhe efikasiteti i zyrave përmbarimore ka qenë më i lartë në përmbyshjen e fazave të ekzekutimit të detyrueshëm të këtyre masave.

DPPPP-ja i ka kushtuar vëmendje të veçantë ndjekjes së proceseve gjyqësore në lidhje me masat administrative të vendosura. Gjatë këtij viti janë 32 çështje gjyqësore të përfunduara, për të cilat janë dhënë 24 vendime nga Gjykata

Tabela 4. Të dhëna të detajuara mbi arkëtimet nga gjocat (2014-2016)

| Zërat | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 |
|--|-------------------|-------------------|-------------------|
| Vendime për gjoba | 57 | 34 | 33 |
| Shuma totale e vlerës së gjobave | 28'530'000 | 34'700'000 | 30'100'000 |
| Shuma e vlerës së arkëtuar në vitin korrent | 18'170'000 | 12'656'000 | 17'660'000 |
| Shuma e vlerës së arkëtuar për gjocat e mbartura | 16'065'705 | 5'000'000 | 14'126'000 |
| Shuma totale e arkëtimit | 34'235'705 | 17'656'000 | 31'786'000 |

Vlera e gjobave në lekë

Nga masat administrative të vendosura gjatë këtij viti, 19 prej tyre janë arkëtuar, ndërsa pjesa tjetër ka vazhduar ankimimin në rrugë gjyqësore.

Për të rritur efikasitetin e ekzekutimit të masave administrative DPPPP-ja ka ndjekur në vijimësi fazat e ekzekutimit dhe ka kërkuar informacion nga zyrat përmbarimore për statusin dhe fazën e ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë

Administrative e Shkallës së Parë dhe janë dhënë 8 vendime nga Gjykata Administrative e Apelit.

Në përfundim të proceseve gjyqësore janë analizuar praktikat në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të procedimit administrativ si dhe të unifikimit të tyre në zbatim të legjislacionit për PPP/FT.

MBLEDHJA, ANALIZIMI, SHPËRNDARJA E INFORMACIONIT FINANCIAR DHE MASAT E PËRKOHSHME

Si çdo NjIF e tipit administrativ, funksioni kryesor i DPPPP-së vijon të jetë mbledhja, analizimi dhe shpërndarja e rasteve të dyshimta për organet kompetente.

Tashmë kemi një sistem të konsoliduar për sa i përket raportimit të rasteve të dyshimta, në kohë dhe me cilësinë e duhur, elemente këto që përbejnë esencën e një sistemi funksional në këtë drejtim.

Për vetë natyrën dhe logjikën e funksionit të institucionit, RAD-et përbëjnë produktin kryesor që shërben si bazë fillestare për referimin e rasteve të dyshimta (mbi 80% të tyre), të ndjekura nga

indicet e analizave sektoriale, njoftimet nga partnerët, raportet e transaksioneve mbi pragun dhe njoftime të tjera.

RAPORTET E AKTIVITETIT TË DYSHIMTË


Gjatë vitit 2016 është ruajtur trendi pozitiv i raportimeve të RAD-eve nga subjektet raportuese për sa i përket numrit të tyre, gamës së subjekteve raportuese dhe cilësisë së tyre, duke vijuar të jenë indice dominuese dhe më e rëndësishme e rasteve të referuara nga DPPPP në organet zbatimit të ligjit.

Tabela 5. RAD-e të raportuara, sipas kategorisë së subjekteve raportuese (2013-2016)

| Subjekti raportues | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 |
|---|------------|-------------|--------------|--------------|
| Banka | 420 | 822 | 585 | 619 |
| Shoqëri transfertash | 45 | 74 | 79 | 209 |
| DPD | 36 | 48 | 45 | 47 |
| DPT | 10 | 50 | 7 | 3 |
| ZQRPP | 20 | 64 | 210 | 134 |
| Noter | 15 | 122 | 303 | 205 |
| ZKV | 8 | 16 | 17 | 14 |
| Shoqëri auditimi | 1 | 0 | 0 | 1 |
| Ekspert kontabël | 1 | 4 | 1 | 0 |
| Institucione financiare të mikrokredisë | 0 | 2 | 0 | 2 |
| Avokat | 1 | 2 | 0 | 0 |
| Shoqëri të qiradhënies financiare | 0 | 4 | 7 | 15 |
| Shoqëri ndërtimi | 0 | 4 | 1 | 0 |
| Shoqëri tregtimi mjetesh motorike | 0 | 9 | 36 | 35 |
| Agjenci udhëtimi | 0 | 0 | 1 | 0 |
| Shoqëri kursim krediti | 0 | 0 | 1 | 0 |
| Shoqëri transporti | 0 | 0 | 2 | 0 |
| Shoqëri pagesash elektronike | 0 | 0 | 19 | 6 |
| Tjetër | 1 | 9 | 5 | 2 |
| Total | 558 | 1230 | 1 319 | 1 292 |

Duke iu referuar statistikave të RAD-ve të raportuara nga bankat dhe me rreth 165% paraqitura në tabelën e mësipërme, vlen të rasteve të raportuara nga shoqëritë e të veçohet rritja me rreth 6% e rasteve të transfertave.

Grafiku 1. Ecuria e raportimeve të RAD-eve për periudhën 2013-2016



DPPPP-ja ka vijuar të përcaktojë prioritetet tyre, konkluzionet e vlerësimit të riskut si në trajtimin e RAD-eve në përputhje me dhe eksperiencën e trajtimit të rasteve nga kategorizimin, natyrën dhe përshkrimin e agjencitë e zbatimit të ligjit.

Tabela 6. Tipologjitë kryesore të raportimeve të aktivitetit të dyshimtë (2013-2016)

| | Viti 2013 | Viti 2014 | Viti 2015 | Viti 2016 |
|--|------------|--------------|--------------|--------------|
| Transferta të dyshimta | 189 | 282 | 351 | 387 |
| Përdorimi i llogarisë individuale për qëllime biznesi/evazion fiskal | 44 | 407 | 52 | 14 |
| Derdhje me para në dorë në shuma të konsiderueshme | 96 | 112 | 105 | 143 |
| Veprime jashtë profilit të klientit | 60 | 55 | 74 | 95 |
| Përfshirje të PEP-së në transaksione | 0 | 10 | 4 | 4 |
| Deklarim/Mosdeklarim i vlerave në kufi | 23 | 48 | 21 | 48 |
| Dyshime për financim terrorizmi | 4 | 8 | 6 | 29 |
| Sponsorizime/dhurime/dhënie huaje nga/për të tretë | 18 | 42 | 102 | 88 |
| Blerje pasurish të paluajtmshme me burim të panjohur të fondeve | 29 | 142 | 421 | 258 |
| Blerje pasurish të luajtmshme me burim të panjohur të fondeve | 0 | 16 | 51 | 57 |
| Mosidentifikimi i pronarit përfitues | 1 | 3 | 0 | 1 |
| Transaksione të mbetura në tentativë | 26 | 23 | 12 | 17 |
| Transaksione të kryera nga OJF | 4 | 5 | 11 | 7 |
| Kryerja e një aktiviteti ekonomik fiktiv | 5 | 2 | 1 | 1 |
| Këmbime valutore në vlera të larta | 0 | 10 | 17 | 16 |
| Përdorimi i instrumenteve bankare me anomali/ falsifikuar (letër kredi/çek etj.) | 4 | 3 | 0 | 2 |
| Përdorim i dyshimtë i kredive bankare | 8 | 9 | 10 | 8 |
| Mashtrim/mashtrim kompjuterik | 4 | 13 | 5 | 12 |
| Veprime nga persona të dyshuar si të përfshirë në veprimtari kriminale | 9 | 15 | 12 | 76 |
| Dyshime lidhur me aktivitete të import/eksportit të mallrave | 13 | 0 | 32 | 0 |
| Transaksione të kryera nga /drejt kompanive të lojërave të fatit | 2 | 3 | 4 | 0 |
| Tjetër | 19 | 22 | 28 | 29 |
| Total | 558 | 1 230 | 1 319 | 1 292 |

ANALIZIMI FINANCIAR DHE REFERIMI NË ORGANET E ZBATIMIT TË LIGJIT

DPPPP-ja mbledh, analizon dhe shpërndan informacionin në organet e zbatimit të ligjit për aktivitete të dyshimta në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Për vitin 2016, DPPPP-ja e ka përqendruar aktivitetin e saj në drejtim të rritjes së efikasitetit të sistemit parandalues përmes bashkëpunimit jo vetëm me subjektet raportuese, institucione të tjera, agjencitë homologe, por edhe me organet zbatuese të ligjit, tek të cilat adresohet produkti final i punës së analizës së DPPPP-së.

Në statistikat e mësipërme nuk përfshihen informacionet vijuese që DPPPP-ja dërgon për raste të referuara më parë në organet e zbatimit të ligjit, të dhëna këto, që në disa raste kanë shërbyer si shtysë për rifillimin e hetimeve apo ecurinë e tyre, duke ndërmarrë hapa të mëtejshëm nga Prokuroria dhe/ose Policia.


Referimet për Policinë e Shtetit dërgohen në nivel qendror dhe më pas kjo strukturë realizon ndjekjen sipas procedurave të brendshme.

Referimet e dërguara në Prokurori janë shoqëruar gjithnjë edhe me njoftimin për policinë e shtetit, në mënyrë që të merren masat përkatëse procedurale për rastet e referuara.

Tabela 7. Rastet e referuara në organet e zbatimit të ligjit (2012-2016)

| | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 |
|------------------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Referimet ne Prokurori | 34 | 35 | 148 | 120 | 120 |
| Referimet ne Polici | 171 | 248 | 314 | 281 | 291 |
| Total | 205 | 283 | 462 | 401 | 411 |

Grafiku 2. Shpërndarja gjeografike e referimeve në prokurori



Përgjithësisht, referimet e DPPPP-së kanë prekur të gjitha rajonet e vendit dhe kjo provohet me anë të të dhënave për shpërndarjen e rasteve në prokuroritë kryesore në vend, ku natyrshëm dominon Tirana për shkak të juridiksionit të shtrirë që ka.

Nëse marrim në konsideratë indicet për rastet e referuara gjatë vitit 2016, në Polici dhe në Prokurori të dhënat paraqiten si më poshtë:

për pikasjen e rasteve të dyshimta. Pavarësisht se DPPPP-ja është njësi e tipit administrativ (pa kompetenca hetimi), mbi bazë të të dhënave konfidenciale apo nga burime të hapura, për një pjesë të konsiderueshme të rasteve të referuara është arritur të evidentohet lidhja e mundshme me veprimtarinë kriminale të origjinës. Siç shihet, në tabelën 9 dominojnë rastet, për të cilat vepra penale mëmë nuk ka mundur të përcaktohet. Për këto raste analiza financiare ka arritur në përfundimin se:

Tabela 8. Rastet e referuara gjatë vitit 2016 në polici dhe prokurori

| | RAD | Analiza sektoriale | RTPF | NJIF partnere | Njoftime | Tot. |
|------------------------|------------|--------------------|-----------|---------------|-----------|------------|
| Referimet në polici | 251 | 19 | 10 | 5 | 6 | 291 |
| Referimet në prokurori | 110 | 1 | 2 | 3 | 4 | 120 |
| Total | 361 | 20 | 12 | 8 | 10 | 411 |

Tabela 9. Të dhëna për klasifikimin e veprës mëmë, të dyshuar gjatë vitit 2016

| Klasifikimi i veprës mëmë të dyshuar | Total | % |
|---|------------|-------------|
| Trafikim/kultivim i lëndëve narkotike | 30 | 7 |
| Trafikim/shfrytëzim i qenieve njerëzore | 7 | 2 |
| Trafikim armësh dhe municionesh | 2 | 1 |
| Precedentë të mëparshëm kriminalë | 10 | 2 |
| Përfshirje në organizata kriminale | 6 | 2 |
| Dyshime për përfshirje në financim terrorizmi/ lidhje me persona të akuzuar për financim terrorizmi | 8 | 2 |
| Mashtrime (mashtrime financiare, mashtrime kompjuterike, skemave mashtruese etj.) | 17 | 2 |
| Mosdeklarime në kufi (përfshirë dyshime, shmangie taksash, evazion fiskal) | 11 | 2 |
| Shmangie detyrimesh doganore | 2 | 1 |
| Korrupsion, kryesisht pasiv / shpërdorim detyre | 9 | 2 |
| Falsifikim | 2 | 1 |
| Vrasje | 1 | 1 |
| Kanosje, armëmbajtje pa leje dhe vjedhje | 2 | 1 |
| Lidhje me praktika të tjera të referuara, lidhje të personave mes tyre | 2 | 1 |
| Nuk dihet | 302 | 73 |
| Total | 411 | 100% |

Indicet e referimeve dominuese nga RAD-et e marra janë një nga treguesit e cilësisë së tyre dhe nga ana tjetër, rastet e referuara bazuar në indice të analizave sektoriale provojnë qasjen konkrete të DPPPP-së edhe në këtë drejtim, punë kjo që ka shërbyer si udhërrëfyes për subjektet raportuese në funksion të shtimit të proceseve të mundshme

- Fondet e qarkulluara nuk kanë pasur burime të ligjshme;
- Veprimet financiare kanë pasur anomali;
- Qëllimi ekonomik-ligjor ka qenë bindshëm i dyshimtë;
- Kanë pasur ngjashmëri të theksuara me tipologjitë e njohura ndërkombëtare.

MASAT E PËRKOHSHME / URDHRAT E BLOKIMIT

DPPPP-ja, në kuadrin e përmbushjes së funksionit parandalues, nxjerr urdhra bllokimi në ato raste kur ka të dhëna apo informacione të mjaftueshme se po kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit.

Për rastet e referuara, për të cilat ka pasur urdhra bllokimi, bashkëpunimi me policinë dhe prokurorinë ka qenë më i ngushtë, në mënyrë që të koordinohen masat reciproke dhe të shmanget tjetërsimi i fondeve.

Tabela 10. Urdhrat e bllokimit dhe sekuestrimet për periudhën 2012-2016

| Viti | Numri i urdhrave të bllokimit | Vlera e bllokuar | Vlera e sekuestruar |
|------|-------------------------------|------------------|---------------------|
| 2012 | 8 | 1,297,066 | 1,145,957 |
| 2013 | 15 | 881,670 | 213,500 |
| 2014 | 65 | 18,183,760 | 13,967,770 |
| 2015 | 47 | 16,278,080 | 11,266,941 |
| 2016 | 61 | 28,772,733 | 8,129,000 |

Vlera e fondeve të bllokuara dhe sekuestruara është paraqitur në monedhën EURO

TIPOLOGJI TË RASTEVE TË REFERUARA NË ORGANET LIGJATUESE

Në kuadrin e rritjes së mëtejshme të kapaciteteve parandaluese të subjekteve të ligjit, në vijim paraqiten disa tipologji të pastrimit të parave/financimit të terrorizmit, të cilat kanë qenë subjekt i punës së DPPPP-së.

RASTI 1. Transaksione biznesi të kryera në CASH (në vlera të larta)

Shoqëria "A", në llogaritë e saj në një nga bankat tregtare në vendin tonë, rezulton se ka kryer transaksione në vlera të larta të tipit tërheqje CASH me justifikimin për shlyerjen e detyrimeve që kjo kishte ndaj furnitorëve të saj.

Nga verifikimet e kryera në të gjitha bankat e nivelit të dytë, në lidhje me këtë shoqëri, rezultoi se në bankat 1 dhe 2, shoqëria "A" kishte kryer një sërë transaksionesh në funksion të aktivitetit që prej krijimit të saj prej afro 10 vjetësh dhe në vijim; ndërsa në bankat 3, 4 dhe 5, shoqëria "A" kishte kryer vetëm nga 4-5 transaksione dhe më pas llogaritë ishin në statusin "e fjetur".

Natyra e transaksioneve dhe anomalitë e konstatuara ishin të së njëjtës natyrë, madje veprimet në banka ishin kryer njëra pas tjetrës, p.sh. si vijon:

Në bankën numër 1.

- Për një periudhë 2 mujore, gjatë vitit 2015 shoqëria "A" ka përfituar tri transfertat në vlera deri në 15 000 000 LEKË për likuidim

faturash nga dy shoqëri të tjera (B dhe C).

- Shumat e përfituara nëpërmjet transfertave janë tërhequr menjëherë CASH me arsyetimin: "likuidim të furnitorëve".

Në bankën numër 2.

- Për një periudhë 2 mujore, gjatë vitit 2016 shoqëria "A", ka përfituar dy transfertat në vlerën totale prej 150 000 eurosh, për likuidim faturash nga dy shoqëri të tjera (D dhe E).
- Shumat e përfituara nëpërmjet transfertave janë tërhequr menjëherë CASH, me arsyetimin e likuidimit të furnitorëve.

Në bankën numër 3.

- Në mars të vitit 2016 ka përfituar dy transfertat, në vlerat totale prej 23 000 000 lekë për likuidim faturash nga dy shoqëri të tjera (M dhe N).
- Edhe në këtë rast, shumat janë tërhequr në CASH me arsyetimin e likuidimit të furnitorëve.

Nga verifikimet e kryera në Qendrën Kombëtare të Biznesit rezultoi se:

- Struktura aksionare e shoqërisë "A" kishte ndryshuar disa herë që nga krijimi i saj. Ortaku themelues i shoqërisë dhe pronari i vërtetë përfitues i saj është shtetasi "X", i cili rezulton të ketë shitur kuotat disa herë

te persona me lidhje të ngushta familjare me të. Së fundmi, shoqëria "A" kishte ortak të vetëm një të afërm të ngushtë të shtetasit "X".

- Gjithashtu, shtetasi "X" rezultoi i përfshirë edhe në disa biznese të tjera në fushën e ndërtimit.

Nga verifikime të tjera, të kryera për shtetasin "X", rezultoi se ai, 7 vjet më parë, ishte arrestuar dhe dënuar për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë dyshimet se:


- Janë hapur llogari bankare në disa banka tregtare njëra pas tjetrës dhe rezultojnë të

jenë kryer vetëm 2-3 transfera hyrëse në vlera të larta, të cilat më pas janë tërhequr menjëherë në CASH;

- Arsyetimet për tërheqjet në CASH janë për shlyerje të furnitorëve, ndërkohë që sipas legjislacionit tatimor, likuidimi i faturave për më shumë se 150 000 lekë është penalizues;
- Ndryshimi i ortakërisë së biznesit, duke përfshirë të afërm të tij të ngushtë, ndërkohë që vetë shtetasi "X" rezultoi me precedencë penale për trafikim të lëndëve narkotike.

Rasti është referuar në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 1



RASTI 2. Përfshirja në transaksione të larta të personave të lidhur me PEP

Shtetasi shqiptar "A" (26 vjeç), në një periudhë të shkurtër kohore, gjatë vitit 2013, ka lidhur 4 kontrata për marrje huaje të një shume totale prej 110 000 eurosh nga 4 shtetas të ndryshëm shqiptarë. Shtetasi "A" rezulton të jetë familjar i ngushtë i një personi të ekspozuar politikisht (PEP).

Duke marrë në konsideratë: 1. moshën e re të shtetasit "A"; 2. mosnjohjen e qëllimit të marrjes së këtyre huave të njëpasnjëshme dhe 3. faktin se shtetasi "A" është familjar i një personi të ekspozuar politikisht, kemi kryer disa verifikime të mëtejshme, nga ku rezultoi se:

Shtetasi "A" sëbashku me vëllanë e tij, shtetasin "B", në maj të vitit 2011 kanë regjistruar një shoqëri tregtare, konkretisht shoqërinë "L sh.p.k", e cila ka objekt veprimtarie "*Dhënie me qira të automjeteve*".

- Pak ditë pasi është regjistruar, kjo shoqëri ka lidhur një kontratë financimi qiraje në shumën 130 000 euro "për blerje automjetesh", nga të cilat 90 000 euro janë financuar nga një kompani *leasing* dhe diferenca (rreth 40 000 EUR) është paguar nga vetë shoqëria, nëpërmjet një depozitimi në CASH të kryer nga njëri prej ortakëve: shtetasi "A".

Pra, shoqëria "L sh.p.k.", në kuadër të kontratës së financimit, ka paguar shumën prej 40 000 eurosh për blerje automjetesh, ndërkohë që është regjistruar vetëm pak ditë para kësaj pagese (burimi i fondeve është i panjohur).

- Pjesa tjetër e mbetur e shumës së marrë

(90 000 EUR), nëpërmjet kontratës së financimit të qirasë nga shoqëria "L sh.p.k." është shlyer brenda një periudhe 1-vjeçare nëpërmjet depozitimeve me para në dorë nga shtetasi "A" (aksionari i saj), por edhe nga një shtetase tjetër, puno-njëse e shoqërisë, nga e cila shtetasi "A" ka marrë një nga huat e sipërpërmendura.

Gjatë investigimit të mëtejshëm të rastit është konstatuar se:


- Në vitin 2011 shoqëria "L sh.p.k." është financuar nga ortaku me një shumë të lartë prej 150 000 eurosh;
- Në vitin 2013, në emër të shoqërisë "L sh.p.k.", është lidhur një kontratë për blerje pasurie të paluajtshme në shumën prej 350 000 eurosh, nga të cilat janë paguar 105 000 euro fillimisht. Burimi i të ardhurave janë deklaruar të jenë huat e marra nga shtetasi "A";
- Kjo shoqëri, për periudhën 2011-2014, rezulton se ka deklaruar pranë organeve tatimore fitime në vlera të vogla;
- Në fund të vitit 2014 shoqëria "L sh.p.k." ka kaluar në statusin "Shoqëri në likuidim e sipër";

Bazuar në dyshimet se:

- Shtetasi "A", familjar i ngushtë i një personi të ekspozuar politikisht, ka deklaruar se ka marrë hua shumën të mëdha;
- Nëpërmjet shoqërisë së tij ka investuar në pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ku shumën prej tij apo prej personave të lidhur me të (burimi i tyre është i panjohur) janë depozituar në CASH;

- Shlyerja para kohe e kontratës për financim qiraje, po nëpërmjet depozitimeve në CASH, financimi në vlerë të lartë nga ortaku i kryer për shoqërinë "L" sh.p.k.;
- Shoqëria, edhe pse ka kryer vazhdimisht investime dhe ka qarkulluar shuma në vlera të larta, ka deklaruar fitime në vlera të vogla. Rasti është referuar në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 2



RASTI 3. Blerje pasurie të paluajtshme në vlerë të lartë nëpërmjet ankandit

Në moshë të re (29 vjeç), shtetasi shqiptar "A", në dhjetor të vitit 2015, rezultoi fitues i një ankandi për blerjen e një apartamenti në shumën 350 000 euro. Duke marrë në konsideratë shumën e lartë të investuar dhe moshën e re të këtij shtetasi, kemi kryer verifi-kime të mëtejshme, nga të cilat rezultoi se:

Pak ditë para fitimit të ankandit, ky shtetas ka lidhur një kontratë për marrje huaje, me një afat kthimi dy mujor, nga shtetasi "R" (mosha 28 vjeç), në të njëjtën shumë të cilën ka paguar për apartamentin e blerë nëpërmjet ankandit (350 000 euro).

Garanci për shumën e marrë hua është vendosur apartamenti i fituar në ankand. Gjithashtu, rezultoi se shtetasi "R", i cili i ka dhënë hua shtetasit "A" ka lidhur një kontratë për marrje huaje në shumën 300 000 euro nga babai i tij, shtetasi "M".

Evidentohet se shuma totale, e cila është përdorur për të blerë apartamentin nga shtetasi "A", është dhënë hua nga shtetasi "R", i cili pjesën më të madhe (300 000 EUR) e ka marrë hua nga babai i tij.

Nga verifikime të mëtejshme në lidhje me shtetasin "A" dhe familjarët e tij, rezultoi se vetëm në emër të shtetasit "A" është regjistruar një subjekt tregtar i tipit "person fizik". Në lidhje me këtë subjekt, rezultoi se fitimet e deklaruar prej tij në organet tatimore janë në vlera të papërfillshme


krahasuar me investimin e ndërmarrë.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë dyshimet se:

- Shtetasi "A" ka blerë nëpërmjet ankandit një apartament në vlerë tepër të lartë;
- Shuma është marrë hua për një afat të shkurtër kthimi nga shtetasi "R";
- Nga ana tjetër, shtetasi "R" e ka marrë hua shumën 300 000 eurosh nga babai i tij;
- Shtetasi "A" ka një biznes në emër të tij me fitime vjetore në vlera të papërfillshme, të cilat nuk mundësojnë shlyerjen e huas së marrë.

Rasti është referuar në organet e zbatimit të ligjit.

Skema 3



RASTI 4. Qarkullim i dyshimtë i shumave të larta në sistemin bankar

Shtetasi shqiptar "R" gjatë viteve 2008-2015 ka qarkulluar pranë një banke tregtare (banka 1) vlera të larta, që arrijnë deri në 350 000 USD.


Historiku i këtij shtetasi pranë kësaj banke, konsiston kryesisht në derdhje, tërheqje dhe më pas investime në depozita me afat.

Në janar të vitit 2015 shtetasi "R" ka kërkuar të tërheqë me para në dorë shumën prej 350 000 USD. Këtë shumë, të cilën shtetasi "R" fillimisht ka kërkuar ta tërheqë në CASH, në shkurt të vitit 2015 e ka transferuar në llogarinë e tij, në një bankë tjetër tregtare (banka 2).

Në prill të vitit 2016, shtetasi "R" i ka transferuar vëllait të tij, shtetasit "H", shumën prej 316 000 USD dhe 4 ditë më pas, shtetasi "H" është paraqitur pranë bankës 2 për tërheqjen në CASH të shumës prej 80 000 USD.

Arsyeja e tërheqjes së kësaj shume është deklaruar për blerjen e një pasurie të paluajtshme, por shtetasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion justifikues.

Skema 4



Duke marrë në konsideratë shumën e lartë të qarkulluar në banka dhe mungesën e dokumentacionit për justifikimin e fondeve, rasti është referuar në organet e zbatimit të ligjit.

RASTI 5. Qarkullim i shumave të larta në llogari nëpërmjet transfertave bankare

Në llogarinë e shoqërisë "X", në një periudhë tre mujore, gjatë vitit 2016 janë kredituar transferta nga subjekte të ndryshme me adresa: Stamboll, Maltë dhe Londër, në vlerë totale ~1.2 milion EUR. Më tej, një pjesë e fondeve (~750 000 EUR) janë debituar nga llogaria nëpërmjet transfertave dalëse për kompani në shtetin "M" (vend *offshore*) si dhe llogarinë e kompanisë "X" në një shtet tjetër "P". Këto transferta pretendohet se janë kryer në bazë të disa marrëveshjeve, që kompania "X" ka nënshkruar me këto kompani.

Bazuar në këto të dhëna, DPPPP-ja ka kryer investigime të mëtejshme në lidhje me rastin, nga ku rezultoi se:


- Shoqëria "X" është themeluar në Londër dhe operon në fushën e ndërmjetësimit financiar, duke ofruar mundësi për kryerjen e pagesave *online*. Aksionari i saj i vetëm është shtetasi "Y" dhe në postin e sekretares është shtetasja "Z".
- Aplikimi për çeljen e llogarisë së shoqërisë është bërë nga shtetasi "Y", i cili rezulton se ka hyrë në Shqipëri për herë të parë në ditën e çeljes së llogarisë dhe është larguar ditën e nesërme.
- Gjeneralitetet e shtetases "Z" korrespondojnë me ato të një shtetaseje, për të cilën ka të dhëna se është e përfshirë në një skemë mashtrimi me kartat e kreditit në USA.
- Të gjitha marrëveshjet që kompania "X" ka me kompanitë me të cilat ka kryer transfertat kanë thujtë të njëjtën formë. Disa prej kompanive me të cilat shoqëria "X" ka kryer transferta rezultojnë se janë

themeluar në vende të njohura si "*offshore*". Nisur nga sa më sipër, DPPPP-ja ka informuar organet e zbatimit të ligjit si dhe ka vijuar me monitorimin e llogarisë së shoqërisë "X", nga ku rezultoi se:

- ✓ Në këtë llogari ka vijuar kryerja e transfertave hyrëse dhe dalëse, kështu p.sh.: deri në fund të vitit 2016 janë kredituar nëpërmjet transfertave hyrëse rreth 8 milion euro.
- ✓ Për këtë rast kemi bashkëpunuar edhe me NjIF homolog.

Nga organet zbatuese të ligjit jemi informuar se është regjistruar një procedim penal ndaj shoqërisë "X" si dhe është vendosur sekuestrimi i shumës prej 1 870 000 euro në llogarinë e saj. Më tej, procedimi për veprën penale të parashikuar nga Neni 287 i Kodit Penal është transferuar në një shtet tjetër "K".

Skema 5



RASTI 6. Qarkullimi i shpeshtë i shumave të larta në sistemin bankar

Shtetasi shqiptar "A", prej vitit 2010, ka hapur disa llogari rrjedhëse në një nga bankat e nivelit të dytë në Shqipëri. Në këto llogari janë kryer, kryesisht, kalime page nga shoqëria "X sh.p.k", konvertime, vendosje në depozitë si dhe transferta.

Nga analizimi i të dhënave ka rezultuar se:

- Shtetasi "A", në fillim të vitit 2016, ka përfituar nga Kina 3 transferta, në vlerë totale ~180 000 euro, me urdhërues shtetasin e huaj "B" dhe me përshkrim "pagesë për pajisje elektronike". Për këto transferta, shtetasi "A" ka deklaruar se kunati i tij, shtetasi "Y" në shtetin "V", ka një biznes të përbashkët me një shtetas kinez. Fitimin e gjeneruar nga ky biznes, ortaku kinez e transferon te llogaria e vëllait të tij në Kinë - shtetasi "B", dhe ky i fundit e kalon në llogarinë e shtetasit "A" me qëllim shmangien e taksave në shtetin "V".
- Nga të ardhurat e përfituara prej këtyre transfertave, shtetasi "A", në korrik të vitit 2016, ka transferuar shumën prej 10 000 eurosh në llogarinë e shtetasit "Y" në shtetin "V" me përshkrimin «transfertë personale».
- Gjithashtu, shtetasi "A" ka kërkuar të transferojë shumën e mbetur në llogarinë e kunatit të tij, shtetasit "Y" në shtetin "V", me përshkrim "kthim borxhi".

Nga analizimi i mëtejshëm i rastit, nga të dhënat tona, ka rezultuar se në emër të këtyre shtetasve (shtetasit "A" dhe shtetasit "Y") ka

raportime të transaksioneve financiare në vlera të larta dhe investime në pasuri të paluajtshme.

Subjekti "X sh.p.k." rezulton se është regjistruar në vitin 2008 dhe ka objekt veprimtarie "*tregtim me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshme*", ku ortake e vetme është e ëma e shtetasit "A".

Nga të dhënat tona për këtë subjekt rezulton se ka zhdoganime, transaksione të shumta bankare në vlera shumë të larta si dhe disa kontrata kredie bankare.


Nga kërkimi në burime të hapura për shtetasin "Y" dhe bashkëshorten e tij ka rezultuar se të dy këta shtetas janë debitorë në shtetin "V" dhe kanë një borxh tatimor që arrin mbi 280 000 euro. Për shlyerjen e këtij borxhi është vendosur si peng ligjor një ndërtesë në pronësi të bashkëshortes së shtetasit "Y".

Në përfundim të rastit, duke marrë në konsideratë:

- Qarkullimin ciklik të fondeve me përfshirje të personave në shtete të ndryshme.
- Deklarimin e tij se këto fonde burojnë nga shteti "V" dhe do të dërgohen sërish atje te shtetasi "Y" (kunati i tij), për të cilin nga burime të hapura ka të dhëna për mosshlyerje detyrimesh tatimore.
- Investimet e larta në aktivitete dhe pasuri të paluajtshme jashtë vendit (shteti "V") si dhe në Shqipëri.

Rasti është referuar në organet e zbatimit të ligjit, në vijim të të cilit është nxjerrë edhe urdhër sekuestro.

Skema 6



BUXHETI, BURIMET NJERËZORE DHE ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE

BURIMET BUXHETORE DHE MENAXHIMI I TYRE


Në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kuadrin normativ si edhe nevojat e institucionit, janë menaxhuar me efikasitet fondet buxhetore të akorduara për DPPPP-në. Janë hartuar pasqyrat financiare dhe është raportuar periodikisht, në mënyrë të detajuar, për realizimin e prokurimeve

publike dhe objektive të vendosur.

Gjatë vitit 2016, fondet e akorduara nga buxheti i shtetit janë ndarë në:

- Shpenzime korrente në vlerë 53'730'000 lekë, të realizuara në masën 71%;
- Shpenzime kapitale në vlerë 3'000'000 lekë, të realizuara në masën 74%.

Grafiku 3. Fondet buxhetore në dispozicion dhe përdorimi e tyre



MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe i burimeve buxhetore është i një rëndësie të veçantë, sidomos në kushtet kur ato janë të limituara. Për këtë, DPPPP-ja ka pasur dhe ka në qendër të vëmendjes, menaxhimin me efikasitet të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të vëna në dispozicion.

Në këtë kontekst, për të mundësuar mbarëvajtjen e funksionimit të institucionit si dhe

sigurimin e rendimentit më të mirë është paraqitur plani i nevojave për rekrutim për vitin 2016. Në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike janë kryer procedurat e konkurrimit dhe pranimit të nëpunësve në shërbimin civil për 5 pozicione vakante, duke e çuar në 26 numrin e nëpunësve civilë, nga të cilët 21 janë nëpunës të shërbimit civil të konfirmuar dhe 5 janë nëpunës civilë në periudhë prove. Me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare, DPPPP-së i është akorduar një shtesë prej 5 punonjësish


me kontratë të përkohshme pune për gjatë të gjithë vitit 2016.

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore është çelësi i suksesit për çdo organizatë. Për këtë, DPPPP-ja ka bërë përpjekje për rritjen profesionale të stafit dhe përfitimit të njohurive të reja në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit përmes trajnimeve të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, njohjen e stafit me dokumente dhe tipologji

ndërkombëtare, të publikuara nga organizma të ndryshme ndërkombëtare, si: FATF, EGMONT Group etj.

Gjatë vitit 2016 punonjësit e DPPPP-së kanë marrë pjesë në 30 aktivitete të ndryshme, si: trajnime, konferenca, seminare, grupe pune etj. Në vitet pararendëse, këto aktivitete kanë qenë përkatësisht: 39 në vitin 2015 dhe 10 në vitin 2014.

Skema 7. Organigrama e DPPPP-së



*28 punonjes

Gjatë këtij viti është ngritur struktura e sigurisë dhe në bashkëpunim e komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, pranë Këshillit të Ministrave, janë realizuar procedurat e pajisjes me certifikatë sigurie për të gjithë punonjësit e DPPPP-së.

Kujdes i veçantë është treguar në sigurimin

e zonave të sigurisë sipas klasifikimit përkatës dhe procedurave të përcaktuara.

Është ndjekur me rigorozitet procesi i vlerësimit të punës dhe performancës së çdo punonjësi, duke i kushtuar rëndësi të posaçme shmangies së konfliktit të interesave dhe përmbushjes të detyrimeve ligjore për deklarimin e pasurive.

ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE

Teknologjia e informacionit është një ndër elementet më të rëndësishme në sigurimin e mbarëvajtjes së punës në DPPPP, duke qenë se sasia e informacionit që raportohet dhe përpunohet ka njohur rritje të vazhdueshme.

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar raportimit elektronik (*online*) nga subjektet e ligjit, që është mundësuar në saje të përmirësimit të moduleve për përdoruesit,

asistencës dhe trajnimeve të zhvilluara, të cilat kanë ndikuar në lehtësimin e dërgimit të informacionit, pa cenuar elementet e sigurisë dhe respektimin e afateve kohore.

Një aspekt i rëndësishëm i punës, gjatë vitit 2016, ka qenë dhe përmirësimi i infrastrukturës së Teknologjise se Informacionit në DPPPP, që ka ndikuar në rritjen e mëtejshme të efektivitetit të mbledhjes dhe analizimit të informacionit.

BASHKËPUNIMI KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Koordinimi dhe bashkëveprimi ndërinstytucional mbeten të një rëndësie primare për të gjitha institucionet e përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Për vetë rolin e saj si qendër kombëtare, DPPPP-ja e konsideron jetësor forcimin e këtij bashkëpunimi, në kuadër të mbikëqyrjes së subjekteve raportuese, shkëmbimin e informacionit me institucione të ndryshme, qasjen në bazat e të dhënave shtetërore apo private, ndërveprimin për bllokimin e aseteve të dyshuara dhe hetimin e rasteve për pastrim të produkteve kriminale.


Ka vijuar bashkëpunimi intensiv me DPPSH dhe Prokurorinë, në kuadër të trajtimit të rasteve që DPPPP-ja referon. Ende hasen problematika në lidhje me mënyrën e hetimit të rasteve. Kjo çështje është adresuar në instanca e takime të ndryshme me Prokurorinë dhe aktorë të tjerë, që kanë rol në këtë proces.

Kemi vijuar bashkëveprimin me autoritetet mbikëqyrëse dhe licencuese në drejtim të aktiviteteve të përbashkëta trajnuese dhe mbikëqyrëse për të mundësuar një përdorim të frytshëm të burimeve si edhe për të lehtësuar proceset audituese për subjektet e ligjit.

Mbetet ende punë për t'u bërë në drejtim të aksesimit të informacionit në kohë reale për disa baza të dhënash, të cilat do të rrisnin efikasitetin e punës së DPPPP-së. Për këtë do të mbetemi të angazhuar, për të zgjeruar më tej këto baza si dhe për të adresuar problematikat në instancat përkatëse.

Rëndësi të veçantë në aktivitetin e DPPPP-së paraqet dhe trajtimi i kërkesave të organeve të policisë dhe prokurorisë në hetimet financiare, që ato procedojnë. Viti 2016 ka shënuar rritje të numrit të kërkesave dhe të numrit të personave për të cilët janë përpunuar dhe dërguar të dhëna. Nisur nga fakti se, angazhimi shtesë i DPPPP-së në kthimin e përgjigjeve për një numër të lartë personash kërkon edhe burime njerëzore

Grafiku 4. Kërkesat për informacion nga policia dhe prokuroria (2014-2016)



shtesë, kemi kërkuar një koordinim më të mirë mes policisë dhe prokurorisë, në kuadër të minimizimit të këtyre kërkesave dhe një reagim prej tyre në lidhje me ndikimin e përgjigjeve të DPPPP-së në hetimet që kryhen.

Vlen të veçohet bashkëpunimi me Shërbimin Informativ Shtetëror dhe Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në kuadër të investigimit të rasteve të dyshuara për financim terrorizmi, ekstremizëm, krim të organizuar, korrupsion dhe shpërdorim detyre.

Gjatë vitit 2016 i është kushtuar një vëmendje e veçantë bashkëpunimit me DPT-në, në kuadër të trajtimit të rasteve të dyshimta me vepër origjine në fushën fiskale dhe të mbikëqyrjes nga organet tatimore të veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse, proces ky me rëndësi të lartë për parandalimin e radikalizmit, terrorizmit dhe financimit të tij.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

BASHKËPUNIMI NË KUADRIN E GRUPIT EGMONT

DPPPP-ja, gjatë vitit 2016, është angazhuar rregullisht në aktivitetet e Grupit EGMONT të NjIF. Në vijim do të paraqiten aktivitetet kryesore të zhvilluara në këtë kuadër.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar pjesëmarrjes në takimin e Grupit të Punës të Anëtarësimit, mbështetjes dhe përputhshmërisë, në të cilin ndër të tjera është diskutuar dhe ecuria e anëtarësimit të NjIF Kosovë në Grupin EGMONT si dhe masat e marra nga autoritetet e Republikës së Kosovës për përafrimin e legjislacionit me rekomandimet ndërkombëtare.

Në shkurt të vitit 2016, përfaqësues të DPPPP-së kanë marrë pjesë në takimet e organizuara në Monako nga Grupi EGMONT.

Disa nga zhvillimet kryesore të këtij takimi kishin të bënin me buxhetin dhe auditin e sekretariatit të Grupit EGMONT, informacionin mbi punën e ekipit përgjegjës për riorganizimin e grupeve të punës, ecurinë e zbatimit të planit strategjik dhe përcaktimin e prioriteteve të NjIF në luftën kundër financimit të terrorizmit.

Në tetor të vitit 2016 u zhvillua në Paris takimi i Komitetit të Grupit EGMONT, në të cilin përfaqësuesi i DPPPP-së mori pjesë në cilësinë e anëtarit të komitetit. Takimi në fjalë u përqendrua në çështjet e zgjedhjes së sekretarit ekzekutiv të grupit dhe prezantimit të vizionit të tij për drejtimin e mëtejshëm të sekretariatit; bashkëpunimi me FATF-an; zhvillimet teknologjike; zbatimi i objektivave strategjik të grupit etj.

BASHKËPUNIMI ME KOMITETIN MONEYVAL TË KIE

Gjatë këtij viti, Drejtori i Përgjithshëm i DPPPP-së ka vijuar kryesimin e delegacionit shqiptar dhe pjesëmarrjen aktive në seancat plenare të Komitetit MONEYVAL, të Këshillit të Evropës, të mbajtura në muajt prill, shtator dhe dhjetor 2016.

Në këtë kuadër, puna e drejtorisë është përge-ndruar në koordinimin e vazhdueshëm të punës ndërinstitucionale me BSH-në, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Jashtme si dhe D.P.P.SH-në.

Komiteti MONEYVAL ka zhvilluar gjatë vitit një sërë vlerësimesh të vendeve anëtare, duke u mbështetur në rekomandimet dhe metodologjinë e FATF-ës, të cilat vënë theksin në efektivitetin e masave për parandalimin

dhe goditjen e aktivitetit kriminal të lidhur me pastrimin e produkteve të veprave penale dhe financimit të aktiviteteve terroriste.

Në vitin 2017 Shqipëria do të jetë subjekt i vlerësimit nga ekspertët e këtij komiteti dhe në këtë kuadër, në muajin tetor të vitit 2016 u organizua një seancë trajnimi me përfaqësues të të gjitha institucioneve shqiptare të përfshira në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Aktiviteti në fjalë i shërbeu rritjes së mëtejshme të kapaciteteve njerëzore, në nivel institucional dhe ndikoi në zbatimin e detyrimeve, që lindin nga rekomandimet ndërkombëtare.

BASHKËPUNIMI RAJONAL

Në dhjetor të vitit 2016 u mbajt mbajtur në Budva të Malit të Zi takimi vjetor i NjIF të rajonit, i cili organizohej me mbështetjen e Organizatës për Bashkëpunim dhe Sigurinë në Evropë. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues të NjIF nga Bosnje-Hercegovina, Kroacia, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia, Sllovenia dhe Shqipëria. Çështjet kryesore që u diskutuan në këtë takim ishin:

- Zbatimi i rekomandimeve ndërkombëtare të FATF-së për personat e ekspozuar politikisht dhe shkëmbimi i eksperiencës së vendeve të rajonit;
- Metodologjia dhe rekomandimet e FATF-ës si dhe sfidat në përmbushjen e detyrimeve, që kanë të bëjnë me vlerësimin e riskut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Mekanizmat aktualë të vendeve të rajonit në drejtim të zbatimit të rezolutave të Këshillit

të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe procedurat e listimit të personave të shpallur si terroristë apo financues të terrorizmit;

- Financimi i terrorizmit dhe mekanizmat e bashkëpunimit rajonal, dhe
- Masat kundër korrupsionit dhe roli i NjIF-it, si pjesë e sistemit parandalues.

Në këtë takim, përfaqësuesit e DPPPP-së kanë shtruar për diskutim anëtarësimin në këtë forum të NjIF-it të Kosovës, si një hap që do të ndikonte në rritjen dhe forcimin e mëtejshëm në nivel rajonal.

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT ME NJIF-IN

DPPPP-ja bashkëpunon me njësitë homologe, anëtare të Grupit EGMONT, në kuadrin e shkëmbimit të inteligjencës financiare.

Bashkëpunimi ndërkombëtar me NjIF-ët homologë përbën një komponent të rëndësishëm të punës së Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave. Informacioni i përcjellë nga homologët ka qenë mjaft i vlefshëm dhe në shumë raste ka çuar në analiza produktive.

Ky bashkëpunim, gjithnjë në rritje, ka ardhur duke u intensifikuar, sidomos me NjIF-in e Britanisë së Madhe, SHBA-së, Italisë, Belgjikës, Malit të Zi, Gjermanisë, Francës dhe Maqedonisë. Përgjigjet ndaj kërkesave të homologëve dërgohen në kohë, duke mos krijuar kështu asnjë pengesë në komunikim apo në mbarëvajtjen e rasteve. Asnjëherë nuk ka munguar bashkëpunimi në kohë nga ana e homologëve për çdo informacion të kërkuar nga NjIF-et shqiptare.

Tabela 11. Të dhëna mbi shkëmbimin e informacionit me NjIF-ët homologë

| Vitet | Kërkesa | | Përgjigje | |
|-------------|--------------------------|------------------------|--------------------------|------------------------|
| | Të dërguara nga DPPPP-ja | Të marra nga Homologët | Të dërguara nga DPPPP-ja | Të marra nga Homologët |
| 2016 | 42 | 76 | 42 | 33 |
| 2015 | 58 | 77 | 63 | 50 |
| 2014 | 66 | 62 | 48 | 47 |

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2017

Përpjekjet dhe puna e bërë gjatë vitit 2016 do të shërbejnë si pikënisje për çuarjen më tej të objektivave të vendosur në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mbetemi të angazhuar për përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor, rregulloreve, procedurave dhe proceseve të punës së DPPPP-së.

Përveç objektivave ligjorë të DPPPP-së, që janë pjesë e detyrave funksionale të institucionit, gjatë vitit 2017, vëmendje të posaçme do të ketë:

- Konsolidimi i procesit të përputhshmërisë mbi bazën e riskut dhe bashkërendimi i punës me autoritetet mbikëqyrëse;
- Forcimi i kapaciteteve të teknologjisë së informacionit;
- Ndjekja dhe koordinimi i procesit të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti MONEYVAL i Këshillit të Evropës si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga ky vlerësim.



Raporti Vjetor

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit
të Pastrimit të Parave

Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
www.fint.gov.al
Ministria e Financave,
Bulevardi "Deshmoret e Kombit",
nr 3, Tiranë.
Tel: +355 4 22 44 602